

Janar-Shkurt-Mars 2016 Botim i Qendrës, Agjencia AJMMI (Agjencia Joniane e Mjedisit, Medias dhe Informacionit) Nr. 014



NGA KALAJA E BUTRINTIT (FOTO: SH.H-AJMMI)

"Urat e Mjedisit"

është botim periodik i Qendrës "AJMMI" (Agjencia Joniane e Mjedisit, Medias dhe Informacionit). Në këtë revistë do të gjeni informacione dhe opinione mbi problematikat mjedisore kryesisht në jug të Shqipërisë si dhe çështje të lidhura me zhvillimin e mediave dhe trajnimin e gazetarëve në një rajon multikrahinor e multi-etnik.

është organizatë joqeveritare, A.J.M.M.I. jofitimprurëse e jopolitike, e përbërë nga specialistë me përvojë të mjedisit dhe medias që operon në fushat respektive të mjedisit dhe medias, përgjithësisht në rajonin Jonian, në jugun e Shqipërisë e me gjerë. Agjencia "AJMMI" është krijuar në vitin 2007.

VIZIONI i Agjencisë "AJMMI: "Miqësor ndaj Mjedisit dhe një Media me fytyrë publike"

STAFI BOTUES

EDITOR: Shkëlqim HAJNO

REDAKSIA:

Kryeredaktor: Dr Agim NELAJ
Panajot BOLI, Blerim KORE
Aferdita SELIMAJ, Sofokli MEKSHI,
Xhorxhi VASILI

KONSULENTË:

Për mediat:
Fatos BAXHAKU - Publiçist
Për mjedisin:
Ing. Kristo KAURI

ADRESA:

Agjencia "AJMMI"/Rr."A.Çuni",
Nr.35.L.Nr.4, Sarandë/
Tel/fax: 0852 25678 / 06922 35 026/
0692708020 / 0683031436

agency_ajmmi@yahoo.com
/ www.ajmmi.com

NR. I LLOGARISE

SOCIETE GENERALE ALBANIA

0001177415

IBAN:

AL 9221363010000000001177415

Qendra AJMMI OJF


NGA BRENDIA

SHËNIME: "Qyteti i Aliut, siç nuk e kisha parë"

Tërmeti, e ka tashmë të qartë se Tepelena, ka qenë mënjeluar (!) nga gudiat turistike të jugut të vendit; megjithëse ajo, edhe gjeografikisht (dhe jo vetëm); është dhe duhet të jetë, një Portë Turistike e Shqipërisë jugore... Në Tepelenë, e famshme si vend i trëndafilut të erërave mes tre luginave lumenjsh, ka nisur vërtet të fryjë një erë e ngrohtë... ta shpëtojme nga aventurat dhe aventurieret e rinj.

Nga Nga Shkëlqim HAJNO

3-5



OPINION : "Zeri. " që humbi në mosdashjen për ta dëgjuar.

Zëri .. nuk është produkt marrëveshesh pro e kunder, aq me pak prone e një individi apo disave në udhëheqjen vendimtare. Ajo është një aset politik e ideologjik i socialistëve shqiptar. Është një histori që nuk mund të zbehet me një urdher, të kujtudo qofte

Nga Panajot ZOTO

10



REPORTAZH: Një ditë në Shtëpinë "Kadare"

Shtëpia "Kadare " vazhdon të tërheqë gjithmonë e më shumë interesimin e grupeve të turistëve që mbrijnë në Gjirokastrë, të cilët kanë kërshërinë të shohin nga afër shtëpinë e lindjes së korifeut të letrave shqipe, Ismail Kadare.

Nga Blerim KORE

6



KUJTIME: "Udhëve të femijerisë, me grekun Andonis Peskos"

Kështu femijeria e jone e perbashket me femijte greke, nisi të rrugetojë neper vitet e rritjes , drejt moshes së shkolles fillore. Edhe ata, djemte e vajzat e familjeve greke u bene bashkenxenesit e shkolles sone

Nga Sofokli MEKSHI

8



OPTIKE: "Shkolla dhe qasja ndaj mjedisit"

Çdo maturë të mbjellë 2-3 pemë, dhe, vit pas viti, të krijohej "pylli i kujtesës", si një memorie e breznive që kanë kaluar nga dyert e kësaj shkolle dhe kanë lënë nga një gjurmë të "gjelbër".....

Nga Xhorxhi VASILI

7



PËRSIATJE: "Momenti i së vërtetës"

Le të respektojme pra konceptet e drejta të Vangjel Zafirrit për jeten dhe unitetin njerezor, për miqësinë, e cila shkatëron hidhenimin dhe mban të fresket shoqëri dhe mjedisin ku jetojme."

Nga Panajot BOLI

12-13



MUZAT: "Sa tokë i nevojitet një njeriu?"

Shërbëtori i tij mori një lopatë dhe gërmoi një gropë aq sa ta merrte Pahomin e gjorë dhe e varrosi aty. Gjashtë këmbë, që nga koka deri tek këmbet, i duheshin për t'ia arritur qëllimit, i gjori.///(Një histori me fuqi të madhe dhe me rezonance globale, sepse lakmia, babezia dhe grykesia janë semundje dhe infektjnë shpirtin e gjithë njerezimit. Askush nuk pranon që mund të jete lakmitar dhe i babezitur.)

Përktheu: Vasilika IFANDI

14-15



Qyteti i Aliut, siç nuk e kisha parë


Kisha kohë pa shkuar ne Tepelenë. Në kujtesën time të pas '90-s, Krijia ne të errët e kalase se Pashait, kish nisur te shtrihej edhe ne blloqet e banimit dhe fasadave të institucioneve. Kjo ngjyre, gjithmonë e bënte edhe më të trishtuar qytetin, krahas kujtimeve të largëta të jetës kulturore e krijuese, me epiqender pallatin e kulturës që mban edhe sot, emrin e Matohitit. Sa e ndjeja veten të pushtuar nga ngjyra gri; i pari nocion që më vetonte në mende ishte "braktisja". Sa në emigrim, aq edhe ne qytete të tjera të vendit. Por sërish, si një magnet, kur rruga më binte tangent nga qyteti për Tiranë, nga dritaret e autobuzit, vidhja shkarazi me sy ndonjë detaj, sa nga muret e kalasë sipër, aq edhe nga Gurëza të Shelgu i fëmijërisë ku dikur kisha peshkuar... Por habitshëm, keto dy vitet te fundit, një erë e ngrohtë ka nisur të fryjë në Tepelenë. Një erë për ta nxjerrë nga harrësa ...Kjo erë, na shtyn drejt vendlindjes me dy miq të mi: një gazetar në pension dhe një inxhinier pyjesh nga Saranda qe s'kishte shkelur kurrë në këtë qytet dhe s'dinte asgjë për të, veç historive dhe lengjendave për Pashain Tepelenas ...

TERMETI, QE KERKON TA NXJERRE QYTETIN NGA HARRESA



Qyteti është kthyer në një kantier pune veçanërisht vitin e fundit. Duket qartë se "gjenerator" i këtij kantieri është Tërmet Peçi, djaloshi kryebashkiak. Shumëkujt, mund të mos ia mbushë syrin, por në Tepelenë thonë : "Tjetrit, shihi punën, jo gunën".

Qyteti, më në fund, po njeh një vullnet te ri vendimarrës, jo për t'u ankuar kafeneve nën tymin e duhanit, por, për të ndryshuar imazh, qasje dhe zhvillim. Për Tërmetin, e nesërmja, është sot. Ndërhyrjet e kujdesshme përreth kalasë se Aliut, krijimi I shetitoreve dhe parkut në qender të Tepelenës, I kanë zënë vendin pejzazheve të papastërtive dhe nje ndjenjë kreativiteti, duket edhe në sytë dhe fjalet e atyre që banojnë sot aty, duke parë sensin serioz të ndërhyrjeve rehabilituese në rrugë, ndërtesa, infrastrukturë, gjelbërimë Tepelena", nga libraria e Niqit deri te Kalaja, ndërsa ndërhyrjet rehabilituese të godinave, shpesh me stil neoklasik, flasin për gusto dhe seriozitet. Tërmeti dhe stafi I tij po punojnë paralelisht për zbatimin gradual të një pakete zhvillimore e promovionale për jetësim e nxitje të aseteve ekonomike, kulturore e turistike të territorit të bashkisë .



Nga Shkëlqim HAJNO

Slogani I kësaj pakete promovionale zhvillimore është: "TEPELENA-PORTA TURISTIKE E SHQIPERISE JUGORE!"

Për shkak të mungesës prej dekadash, të vëmendjes; Tepelena nuk ka patur akses përfitimi as nga projekte e progame të rëndësishme zhvillimi si ato nderkufitare (INTERREG, IPA, etj.). Tërmeti, e ka tashmë të qartë se Tepelena, ka qenë mënjanuar (!) nga gudiat turistike të jugut të vendit; megjithëse ajo, edhe gjeografikisht (dhe jo vetem); është dhe duhet të jetë, një Portë Turistike e Shqipërisë jugore.. Tepelena, ish rezidenca e parë zyrtare e Ali Pashë Tepelenës; rezervon aktualisht një diversitet e asete pasurish ekoturistike, të trashëgimisë kulturore , etnografike, gjeonatyrore ,etj., që duket se po zënë të evidentohen pjesërisht. Bashkia dhe territori i saj, mund dhe duhet të shndërrohen në një destinacion turistik të preferuar për turistët vendas dhe të huaj që I drejtohen Jugut të Shqipërisë.

vijon në fq 4

ASETE QE PRITET TE ZGJOHEN...

Monumenti I Ali Pashë Tepelenës, një vepër e arrirë e skulptorit Muntaz Dhrami në hyrje të qytetit, ka ardhur koha të shoqërohet me Muzeun e Pashait në mjediset e Kalasë së Tij, (pjesë e një kompleksi klulturor) për të pritur turistë vendas e të huaj. Siç është nevojë edhe promovimi përmes një ZIT (Zyre të Informacioni Turistik) në hyrje të qytetit; rikonceptimi I Muzeut historik si një destinacion; një Galeri e arteve pamore, etj.. Në Muzen e pritshëm të A.P.Tepelenës, studjuesi I pasionuar Dorian Koçi (djalë I këtij qyteti) dhe kolegë të nderuar të tij si Pellumb Xhufi , etj., ndoshta duhet të hedhin më shumë dritë për opinionin e gjerë publik : se përse Pashai Tepelenas është hegjemoni I parë shqiptar dhe një figurë identitare shqiptare që shënjon momente të rëndësishme të jetës politike, sociale e kulturore brenda dhe përtej Epirit ? Pashai I Tepelenës

dhe Janinës ka qenë vetëm dhe thjesht një despot i pamëshirshëm, siç përsëritet rutinë në disa vepra të bashkëkohësve të tij , apo edhe njeriu, nën zotërimet e të cilit lulëzuan disa zhvillime kulturore e me pas, politike të rëndësishme me rrezatim edhe për Greqinë e cila do të fitonte pavarësinë më 1821-n, me kontribut të patjetërsueshëm të arvanitasve me gen shqiptari? Sot, Kalaja e qytetit, qëndron e heshtur por, me muzen e pritshëm, do të ketë të tjera zhvillime aq të munguara. Libri I Dorian Koçit “Gjenealogjia e Ali Pashë Tepelenës” që sapo ka parë dritën e botimit, pritet të plotësojë një vakuum te rendesishem në këto drejtime, sikundër, edhe për vetë platformën dhe jetësimin e Muzetut të Ali Pashë Tepelenës në Tepelelenë.

NJE PARK NATYROR DHE DESTINACIONE TURISTIKE. PO KU?

Disa muaj më parë, në bisedë në Sarandë me një zyrtarë

të Tiranës, kur i përmenda idenë e turizmit në Tepelenë, buzëqeshi skeptike... Por, këtë skepticizëm, duket se duan ta flakin tej ata, që e administrojnë sot qytetin e Aliut. Tërmet Peçi thotë se “Kalaja e Aliut do të jetë një kalë beteje për turizmin që duam të nxisim”. “Ai flet edhe, e bën!”- të thonë në Tepelenë. Duket se me zgjerimin e territorit administrativ, po zgjerohet edhe vizioni. Ndaj, ai përmend punën për një plan menaxhimit të parkut të ri rajonal natyror në hapësirën Bënçë-Kurvelesh, ku ruhen pasuri të mrekullueshme ekoturistike, ende të paeksploruara të trashëgimisë dhe gjeomumentale; përmend vullnetin që qyteti të ketë së shpejti edhe një Zyrë të Parkut në një prej fshatrave të Kurveleshit, ; sikurse përmend ngritjen e një Galerie të Arteve figurative në ndërtesën monumentale të pallatit të kulturës që mban emrin e Mustafa Matohitit.

vijon në fq 5



SHËNIME

vijon nga fq 4

Destinacione turistike. Po KU?: Në Muzeun e historik të rikonceptuar me disa pavione, në Muzen e Ali Pashë Tepelenës brenda në Kalanë e tij; në Parkun Rajonal Natyror Bënçë-

Kurvelesh (që pritet të marrë statusin ligjor); në Ujin e Ftohtë, etj.; për grupe të ndryshme interesi, për vendas e të huaj që duan të mësojnë më shumë, për këtë djep shqiptar, mjaft pjellor

me tradita, me figura dhe njerës të talentuar.

Në Tepelenë, e famshme si vend i trëndafilit të erërave, mes tre luginave lumenjsh, ka nisur vërtet të fryjë një erë e ngrohtë....

Nga Shkëlqim HAJNO




- AJMMI - FOTOKRONIKE - TEPELENA - AJMMI - FOTOKRONIKE - TEPELENA - AJMMI - FOTOKRONIKE - TEPELENA -



Kanionet e Kurveleshit



Basorelievi per Lardin Bajron ne Tepelene



Monumenti i Ali Pashë Tepelenës



Porte ne Kalanë e Ali Pashë Tepelenes

Një ditë në Shtëpinë “Kadare”

Tashmë shtëpia e lindjes së korifeut të letrave shqipe, Ismail Kadare, në Gjirokastrë po shërben si një qendër e rëndësishme jo vetëm për vizitorët vendas dhe të huaj por edhe për nxitjen e organizimeve artistike dhe kulturore. Shtëpia e restauruar plotësisht celi dyert në 80-vjetorin e lindjes së Kadaresë. Ajo po mer profilin e një muzeu për jetën dhe veprën e shkrimtarit të njohur duke u vizituar nga turistë të shumtë ndërsa në mjediset e saj janë organizuar edhe aktivitete kulturore.

Në mjediset e brendshme të shtëpisë ...

Falë zbatimit të projektit restaurues shtëpia e gurtë në lagjen Palorto, e cila u dogj aksidentalisht në nëntor të vitit 1999 tashmë ka mar një profil të vecantë arkitektonik. Për kthimin në identitet të shtëpisë në të tri katet e saj janë përdorur guri, gdhendjet artistike ne dru si dhe xhami. Shtëpia e gurtë, së cilës Kadareja në romanin e tij “Kronikë në gur”, i kushton faqe të tëra në përshkrimin letrar aktualisht është kthyer në një element të vecantë të prezantimit të vetë qytetit, Gjirokastrës. “Projekti i rikonstruksionit të banesës së Ismail Kadaresë, është realizuar pas një studimi profesional duke parë objektin në vend, duke shfrytëzuar dokumentacionin fotografik dhe

skicor ndërkohë që janë marrë edhe mendimet e familjarëve dhe miqve të familjes Kadare duke iu afruar në maksimum gjendjes që ka pasur ky monument para djegjes”, thotë arkitekti Agron Doraci. Sipas tij, nëpërmjet zbatimit të këtij projekti u synua një rikonstruksion hipotetik i shtëpisë së gurtë përshkrimi i së cilës zë një vend të veçantë në veprën letrare të Kadaresë dhe veçanërisht në krijimet e tij që e marrin subjektin nga Gjirokastra e gurtë. Gjatë fazave të zbatimit të këtij projekti është realizuar restaurimi i ambjentëve duke i qëndruar besnik elementëve të restaurimit që ka patur banesa në gjendjen e saj fillestare. Gjatë këtyre fazave është realizuar restaurimi i ambjentëve të tilla si stera e shtëpisë, rikonstruksioni i katit të parë dhe të dytë, mjedisëve të jashtë të banesës etj. Si pjesë e këtij projekti është edhe restaurimi i galerisë së gurtë me arkadë në pjesën jugore të banesës. Konceptimi arkitektonik i banesës së Kadaresë krahas restaurimit të shtëpisë i vjen në ndihmë edhe kthimit të saj në një qendër të vizitueshme si dhe për organizimin e aktiviteteve të ndryshme kulturore.

Mysafirë në banesën e Kadaresë ...

Shtëpia Kadare” vazhdon të Shtëpëqë gjithmonë e më shumë interesimin e grupeve të turistëve



Nga Blerim KORE

që mbrijnë në Gjirokastrë, të cilët kanë kërshërinë të shohin nga afër shtëpinë e lindjes së korifeut të letrave shqipe, Ismail Kadare. Gjatë këtyre javëve ajo ka pritur vizitorë të shumtë

duke u bërë një ndër pikat më të kërkuara për turistët që vizitojnë qytetin. Turistët vendas apo të huaj kërkojnë të shikojnë dhe prekin nga afër muret dhe harqet e gurta të shtëpisë në të cilën ka lindur dhe ka kaluar fëmijërinë dhe rininë e hershme Kadareja. “ Shume herë më është dashur që të udhëzoj turistët për shtëpinë e Kadaresë dhe vendodhjen e saj”, thotë njeri prej banorëve të lagjes Palorto duke shpjeguar se shtëpia e gurtë kërkohet vazhdimisht nga vizitorët. E vecantë është se krahas grupeve turistike banesën e Kadaresë po e vizitojnë edhe nxënës shkollash dhe të rinj që dëshirojnë të njihen me jetën dhe veprimtarinë e tij.



Shkolla dhe qasja ndaj mjedisit

(Në optikën e Xhorxhi Vasilit - Njeriut pa moshë)

Me një eksperiencë 40 vjeçare, si një nga figurat e shquara të arsimit në Sarandë, Xhorxhi Vasili ende, nuk pushon së kontribuari si një veprimtar, herë në fushën e arsimit, posaçërisht të gjimnazit "Hasan Tahsini", e herë në atë të sporteve, si një kronikan e komentator, autor librash në këtë fushë etj. Bash për këto arsye, sot ai që ende nuk e njeh, nuk ia "lexon" moshën. Ka vitë në pension është më aktiv se shumë mësues te rinj. Ka përfunduar pak vite më parë së bashku me mësuesin e shquar Vasil Partali realizimin e muzeun e gjimnazit "Hasan Tahsini", por ende i "hanë duart" për punë të tjera Xhorxhit, "njeriut pa moshë".)

-Si e sheh qasjen e shkollës ndaj problematikës së mjedisit?

-Do ta shihja në dy aspekte. Gjate periudhës që unë kam punuar në shkollë, nuk kanë munguar aktivitete brenda mësimit dhe jashtë tij, si tip leksion, thirrje, kërkesa, etj., veprimtari figurative, që finalizoheshin disa herë me aksione për përmirësimin e mjedisit. Por pas viteve '90, aktivitetet mjedisore në shkolla nisën të zbeheshin ose të kishin ritualin e fushatave. Në vitet '95-'96 nisën lëndët me zgjedhje si edukim mjedisor, etj, madje, patëm edhe një projekt,

disa aktivitete nga program AEDP i SOROS-it. Në këtë fazë edhe problematika e fokusimit të mjedisit me miniprojekte, kapi një koncept më bashkohor. Shkolla "Hasan tahsini" përgatiti madje edhe një simpozium ku pr herë të parë u raportua nga vetë nxënësit, krahas më çështje të tjera të sensibilizimit kundër përdorimit të dgoës, etj., Qeveritë e nxënësve e kishin rrokur tashmë aspektin e mjedisit si një nga çështjet e punës së tyre. Në fakt problemet me jedisin duhet të fokusohen më së shumti në shkolla ne kishtet e mundësive të mëdha që janë sot., Kujtoj se ne viotet n'63-'69 mjedisi përreth gjimnazit ["H. Tahsini": ishte rëpirë. Nuk u pritën direktiva por me nxënës e mësues u transformua mjedisi përreth shkollës, aq sa sot është vështirë ta m bash mend si ishte.

-Mos ngatërro koncepti i vullnetarizmit monist në qasjet mjedisore ?

-Në konceptin tim, vullnetarizmi mjedisor sot ka pse të të ngatërrohet me ngjyrimet e tjera. Mjedisi përreth shkollës duhet mirëmbajtur nga vetë nxënësit dhe ẽmsuesit pa pritur që për cdo gjë të mbahen sytë vetëm nga bashkia.. Ka shumë



Nga Xhorxhi VASILI

propagandë sot. Ka edhe fushatizëm të llojit pluralist!! Nuk e pengon askush që një shkollë e mesme të aplikojë për një thirrje mjedisore, ta fitojë projektin dhe ta zbatojë vetë atë me masën e nxënësve për mjedisin e gjelbëruar. Psh. Idetë e gjelbëra sot mbështeten dhe burime financimi mund të gjenden por së pari, duhet vizionidhe argument. Shembulli I një oazi të gjelbëruar në shkollën hoteleri turizëm "Antoni Athanas"; mund të bëhet edhe më i avancuar në gjimnazin "Hasan Tahsini". Imagjinoni psh: që të marrë jete një nismë e një miniparku pas "Hasan Tahsini". Çdo maturë të mbjellë 2-3 pemë, dhe, vit pas viti, të krijohej "pylli I kujtesës", si një memorie e breznive që kanë kaluar nga dyert e kësaj shkolle dhe kane lënë nga një gjurmë të "gjelbër". Gjurmë, aq të nevojshme në pejzazhin prej betoni të qyteteve tona.

Bisedoi: Sh. HAJNO

Udhëve të fëmijërisë ,me grekun Andonis Peskos - 15 vjet emigrant, në fshatin Nivicë -

Eh femijeria,,Cdokush e ka nje E moshe te tille. Duke kaluar permes nje rruge te ngushte, njeriu ecen drejt shtigjeve te jetes pambarim. Perjetimet e ketij rrugetimi sa te gjate po aq edhe te veshtire,mbesin te pashlyera ne kujtesen e secilit edhe tani ne moshen e trete. Femijeria ime e veshtire, si e gjithë bashkmoshatareve te mi ne Nivice-Sarandë, nisi ne vitet e fundluftes se Dyte Boterore. Vendi yne sa kishte nisur te ecte I lire ne radhen e kombeve. Por ne shtetin fqinj me ne, ne Greqi, kjo lufte ende s'kishte perfunduar. Fuqite nderluftuese nuk I kishin pastruar llogarite midis njeri-tjetrit per ndarjen e sferave te influences. Qeveritaret Grek endeshin ne endrren e tyre, sa me Lindjen po aq edhe me Perendimin. Aq e vertete eshte kjo sa qe gazetari dhe shkrimtari ihuaj Robert Kapllan ka shkruar njelibër te tere me titullin” Greqia, gruaja e lindjes dhe dashnorja e perendimit” Porse ky qendrim I dyzuar e coi ate popull ne nje lufte civile , e cila u kushtoi jeten mijra grekeve dhe perzenien prej vendit te tyre te mijra te tjereve. Si epillog dramatic te asaj lufte, me

marrveshjen e Varkizes, shume kundershtrre te regjimit u debuuan drejt vendeve te Ballkanit, midis tyre edhe ne Shqiperi. Fati e deshi apo politika e vendosi qe, rreth 20 familje te debuara te vendoseshin ne fshatin tone. Me e madhja prej tyre, familja e Ziko Peskos u vendos ne shtepite e Dhimespire, fare prane shtepise sone. Pikerisht ketu ze fill edhe femijeria ime e perbashket me grekun-femije, Andonis Peskos. Ata ishin 4 femije. Me madhja prej tyre Eftihia, pastaj Minai, Andoni dhe me I vogli Stavri. Duke rendur sa andej-ketej neper fshat , ne, kohe mepare kishim degjuar se ne fshat do vinin ca te huaj, por nuk dinim me teper se cfare ishin, nga vinin dhe pse vinin tek ne.Me te medhejte na tregonin se jane greker, nga matane kufiri, ,I kane ndjekur nga shtepite e tyre dhe kan ardhur ketu te shpetojne koken. Por kureshtare, sic eshte kjo moshe, ne pyesnim me te medhenjte e fshatit, Stefan Thomarin, Filip Kosten e Llambi Papadhimen. Ata flisnin greqisht me te porsaardhurit , e na spjegonin: Ne kemi qene ne token e tyre kur kufijte ishin te



Nga Sofokli MEKSHI

hapur. Nevitin e Luftes se Pare, ne katermbedhjeten, grate megjithe femijte e Nivices, me bezinata shkuan ne Qerqira(ashtu e quanin ata Korfuzin) dhe ndenjen aty gati njevit,per te shpertuar nga Turqit.Ne e kemi ngrene me pare buken e tyre, ndaj nuk I lem rrugeve keta. Kryetari fshatit Filip Kosta, shkonte shtepi meshtepi, bente thirrje per ndihme dhe I strehonte ne shtepite e boshatisura te fshatit. Dhe ata rreth 60 – 70 banore te ardhur nga Greqia jetuan e punua ne Nivice, bashke me ne si n je familje. U integruan shume shpejt dhe qendruan deri ne vitin 1963, kur u riatdhesuan te gjithë.Tashmei kthimii tyre ishte dinjitoz, plot me mall e gje te gjalle, qe I bene me djersen e tyre. Duheshin vitet 90 te tragjedise shqiptare dhe ato te viteve 2010-2016 te tragjedise Siriane qe ne te kuptonim qartazi ate qe perjetuan grekerit e ardhur ne Nivice ne vitin 1949-50 te shekullit te kaluar. Njerzit ne anet tona, por edhe

vijon në fq 9



kudo ne bote e kane si emerues te perbashket, mikepritjen. Ne sofren e tyre te varfer ka gjithmone vend dhe buke per ate qe eshte ne nevoje.

Mesuesi Andon ne gare me nxenesin Andonis

Keshtu femijeria e jone e perbashket me femijte greke, nisi te rrugetoje neper vitet e rritjes , drejt moshes se shkollës fillore. Edhe ata, djemte e vajzat e familjeve greke u bene bashknxenesit eshkollës sone. Ajo ngrihet ne mes te fshatit, atje qe prej vitit 1917,perball kishes se Shendhimitrit sikur duan t'I bejne karshillek njera tjetres. Dy filozofite,njer fetare e tjetra materialiste”debatonin” neper tekstet e emesimeve.

Pikerisht ne kete kishë, nevitin 1958, prifti Stavro Rexho nga Dhivri, na beri vllomer, mua me AndonPeskon , Spiro Gurmen, Lask Llolli. Thodhori Prifti e Vasil Stavri . Por le te kthehemi ne shkollë e te flasim per banoret e saj te perkohshem.Ne femijte niviciote, por edhe ata greke, ca na kureshtja e ca nga nevoja e komunikimit , kishim avancuar shume ne mesimin e gjuhes se njeri- tjetrit.Nxenesit greke filloren e benin ne gjuhen e tyre amtare..Ne nje klase te vecante, mesuesi Gaqo Vjero, te gjitha lendet ua bente greqisht, ndersa u mesonte edhe shqip, si gjuhe te huaj.Ne klasen e peste, si gjitone qe isha me Andon Peskon, mesuesi Andon na vendosi ne nje banke.. Ne te tjeret mbanin nga nje cante me libra, ndersa greku Andon vetem nje fletore dhe nje stilolapes me maje plumbi. Ishte shume I zgjuar e I kapte shpejtmesimet. Sidomos ne shkenca ekzakte ishte absolut.Shume nga bashknxenesit e asaj klase, nga largesia e 60 viteve, kujtojme ende nje thenie te



Mina Peskos dhe kënetari Koço Bodini
Nivice

mesuesit Andon” kush e zgjidh I pari ushtrimin , pervec Andon Peskos, do te marre noten 5” Mesuesi e kishte bere zakon qe ne fund te ores se mesimit, na jepte nje ushtrim per te zgjidhur per te kuptuar sa kishim pervehteuar nga ajo ore mesimi.Por Andoni medy veprime e nxirrte shpejt pergjigjen , duke perfutuar noten maksimale.Ne, te pakenaqur me faktin se noten pese e merte gjithmone greku Andon, shkuam nje dite ne drejtori. Por edhe aty drejtor ishte mesuesi Andon Baxheri.Na mirkuptoi dhe qysh nga ajo dite vendosi kushtin”pervec Andonit”Ne te gjithë nivelet e shkollimit tim , me ka habitur aftesia e nxenesve nga zonat e minoritetit etnik Grek, per te qene absolut ne Matematike e Fizike. Duhet te besojme se eshte nje aftesi e tyre genetike por edhe e vullnetit qe kan. Pas7 vjecares, nxenesit grek, I cuan ne shkolla si ne Durres, Tirane etj. Minai perfundoi Politeknikumin “7 nentori “(ish shkolla Harri Fullts. Madje ai punoi si teknik I mesem ne nje nga minierat tona te veriut deri sa u kthye ne atdheun e tij se bashku me familjen. Barba Ziko nuk donte te kthehej me ne Greqi, por qeverria e vendit te tij, I detyroi te ktheheshin andej nga kishin ardhe, te debuar me force.

Rikthim pas 40 vjetesh ne Nivice.

Me hapjen e kufijve ne vitin 90, kisha shkuar disa here ne Greqi dhe I kisha ftuar vllenzrit Pesko, per nje vizite ne fshatin tone te perbashket, sic Iu pelqen ta quajne ata Nivicen. Dhe Andoni erdhi. Dhe jo vetem nje here.Dhe jo vetem ai. Te tre vllenzrit dhe motra e tyre vijne gati cdo dy vjet ne fshat. Por hera pare qe u takova me Andonin, ndodhi ne vitin 2000. Ai jeton e punon ne Australi qysh nga vitet 70, por e ka fiksime te vije ne Nivice, Bashkfshatri im taksixhi Lefter Thomai me kishte ruajtur nje surprize. Me gjeti tek sheshi para Bashkise dhe me tha” Do te takosh nje njeri te rralle. Ai ka kerkuar shume here te te takoj por ti nuk je ndodhur ketu kur ka ardhur ai.” Une e shikoja me habi Lefterin dhe kurre nuk me shkonte mendja te Andoni nga qe ai ishte shume- shume large. Shoferi kishte lene takim para sheshit te Bashkise dhe e priste nga casti ne cast.” Ja, perpara e ke, do ta njihni njeri tjetrin apo jo” me tha Lefteri.

(vijon në numërin e ardhshëm)

“Zeri..” që humbi në mosdashjen për ta dëgjuar



Nga Panajot ZOTO

Ky është titulli i nje shkrimi qe ngeli pa u botuar, jo per shkak se nuk ke meritonte botimin,por se vet u vetfrenova per ta cuar ne ndonje prej gazetave te perditshme. Pse? Pasi mosdalja (mbyllja) e gazetes “Zeri i Popullit” nuk ka qene deshire e partise (udheheqesise) qe i perkiste si organ, por edhe e medjave te tjera....

I ndodhur para faktit se shume nga ish koleget e mi gazetar qe kemi milituar ne kete gazete kane botuar keto dite statuse me kujtimet e tyre dhe denoncojne mbylljen e keaj gazete, faktin qe edhe ne kongresin e fundit te PS askush nuk foli per nevojën e botimit apo te denonconte mbylljen me urdher te kesaj gazete, po citoj disa pasazhe nga prononcimi im per kete ceshtje..

Dua te them , se pari, se ne vorbullen politike te kohes, shume ceshtje, edhe se jo pa rendesi, kalojne pa u ndjere. Rokullisen ne skakieren e debateve pa fund dhe lenë kohen te beje punen e vet. Keshtu dhe me ceshtjen Zeri i popullit.

Nenvizoj se tregut mediatik i mungojne edhe gazeta te tjera, qe jane mbyllur thkjesht e vetem per pa mundesi financimi, Ne se ky eshte shkak per mbylljen e “zerit te popullit”, pergjegjesia nuk eshte e stafave drejtuese,p0or e nje vullneti politik te munguar per gjetjen e mundesive dhe rrugeve per mbeshtetje financiare. Eshte e dukshme se gazeta eshte lenë ne reshqitje te lire, ne tatepjeten e padeshires per ta patur ate ne treg, deri ne rezimin perfundimtar ne honin e hareses.

Tregut mediatik i mungojne edhe gazeta te tjera, por termi “Mungese” nuk ka te njejten vlere krahasimi,kur behet fjale per nje gazeta se “Zeri i Popullit”, me nje histori, ku perpjekjet per ta fshire ate nga kujtesa e socialisteve nuk mund te jene pa pasoja. Zeri i popullit ka mbijetuar ne vite e kohe me te veshtira per PS duke luajtur nje rol paresor ne ngjizje te ndergjegjes politike te elektoratit mbeshtetes te PS.Ne vite te veshtira te historise se saj , kur PS ne opozite vidhesh ne kutite e votimit dhe rihej shesheve te vendit nga salinjte e kohes,kjo gazete dhe gazetaret e saj kane sakrifikuar dhe mundesuar nxjerrjen me mbi 40 mije kopje, duke mbajtur lart moralin dhe ngjallur shpresen te elektorati i majte....

Pse nuk flet kush sot per kete gazete ne piramiden e partise. Pse nuk flasin

ata qe kane nisur karjeren politike nga zyrat e kesaj gazete dhe jane ende sot ne politike? Heshtja krijon gjithnje pikpyetje dhe, mungesa e transparences, dyshime. Le te thuhën hapur arsyet e mbylljes. A eshte i vertete justifikimi se gjithshka lidhetme mungesen e shitjeve, me mospelqimin e saj nga vet lexuesit, nga socialistet? Besoj jo. Te pyeten, domosdoshmerisht, socialistet ne se e duan gazeten e partise se tyre (pasi edhe LSI-stet apo PDI-stet, FRD-istet e kane gazeten e tyre), apo jo.

“Zeri i Popullit” nuk eshte produkt marveshjesh pro e kunder, aq me pak prone e nje individi apo disave ne udheheqien vendimmarese. Ajo eshte nje aset politik e ideologjik i socialisteve shqiptar. Eshte nje histori qe nuk mund te zhbehet me nje urdher, te kujtedo qofte.

AJMMI - FOTOMEMORIE- AJMMI - FOTOMEMORIE- AJMMI - FOTOMEMORIE - AJMMI - FOTOMEMORIE- -



Marka e re e Parkut Kombetar te Butrintit



PPNEA, organizoi se fundi ne Sarande nje takim konsultativ per formezimim e Markes se Re te Parkut Kombetar te Butrintit. Me zhvillimet e reja qe ka mare ky Park pas perfshirjes ne te edhe te hapsirave te Lagunes se Butrintit e te liqenit te Rrezes , por edhe me gjere, te kodrave deri ne dalje te qytezes se Ksamilit, lindi e domosdoshme dalja me nje Logo te re. Perpara nje autoditori te gjere me pjesemarrjen e perfaqesve te Shoqatave te ndryshme qe veporojne ne rajonin e Sarandes, por edhe veprimtare vullnetare te mjedisit, u prezantuan fillimisht disa nga modelet e reja perfaqesve te Logos se re. Drejtori I PPN-es Mirjan Topi spjegoi permbajtjen e seciles prej tyre dhe kriteret e perzgjedhjes qe duhet te bejme. Gjergji Mano, drejtor I Parkut Kombetar te Butrintit, foli per domosdoshmerine e e krijimit te n je marke t e re sa me perfaqesve , e cila te reflektoje relitetet e reja te zones. drejtori ekzekutiv I AJMMI-t Shkelqim Hajno shprehu opinionin e vet se varianti nr.4 eshte me realiste per Parkun, ndersa pjesmarres te tjere favorizonin skicen nr 2. Se fundmi u konkludua qe Marka e re e Parkut Kombetar te Butrintit te formezohej ajo sipas fotografise qe shoqeron kete kronike te shkurter. Ne vazhdim te takimit, pjesmarrsit shkembjen mendime per gjallerimin e metejshem te veprimtarise se organizatave e te Shoqatave qe veprojne ne Rajonin e Sarandes me synimin qe puna e tyre te reflektoje ne vendimmarrjen e organeve te pushtetit local per problemet qe shqetsojne shoqerine e sotme.

S.M.- AJMMI – Sarande.

“Dita Kulturore Minoritare” ne Permet



Femijet e talentuar të Përmetit
Foto SH.H-AJMMI

Në qytetin e Përmetit Nështë orgaznizuar “Dita Kulturore Minoritare Përmetare”. Pjesmarrës në këtë aktivitet ishin figura të spikatura të minoritetit egjiptian, vllah dhe grek në zonën e Përmetit si dhe gazet përmetare, grupi polifonik “Pogoni” dhe grupi “Punëtori” që prezantuan një program me këngë


të minoriteteve përkatëse. “Dita Kulturore Minoritare Përmetare” u realizua si pjesë e programit të financuar nga Bashkimi European dhe zbatuar nga Këshilli i Europës me titull “Promovimi i të drejtave të njeriut dhe mbrojtja e minoriteteve”. Bashkia Përmet si përfituese në këtë program, prej një viti zbatoi projektin “Investim per barazi” duke realizuar një sërë aktivitesh me pjesmarrjen e minoriteteve të ndryshme. Përgjatë Ditës kulturore minoritare në përmet u prezantua edhe botimi dy gjuhësh i titulluar “Histori sukcesi-Njerëz dhe vlera Përmetare”. Në faqet e këtij botimi prezantohet kontributi që kanë dhënë për komunitetin figura të shquara te minoritetit egjiptian, vllah dhe grek në zonën e Përmetit. Sipas kordinatores së projektit,

Elena Mullaraj “përfshirja e këtij target grupi dhe nxitja e interesit të tyre kundrejt të drejtave civile, kundrejt të drejtave ndaj skemës së ndihmës ekonomike, e drejta e votës, kujdesit shëndetsor, etj ishin aktivitete me shumë dobishmëri për minoritetin në qytetin e Përmetit ndërkohë që nisma të tilla vlejnë të kenë vazhdueshmëri dhe qëndrueshmëri për të ardhmen”. Përgjatë aktivitetit supervizorja e projektit, Irena Karagjozi, u shpreh se “projekti arriti objektivat e tij në mënyrë cilësore gjë e cila u reflektua nga mënyra sesi minoriteti dhe pakicat e mbështetën projektin qysh në fillimet e tij ndërkohë që aktivitetet që u realizuan përgjatë tij ishin produktive për komunitetin përmetar”.

Blerim KORE

Momenti i së vërtetës

-Bisedë me kirurgun e njohur Dr.Dhimitër XHAFERI-



-Doktor, sapo keni botuar librin “Moment i së vërtetës “. Nuk është hera e pare që prezantoheni edhe si autor letrar. Te botimi I fundit, shprehni konsideratat për veprën e Vangjel Zafiratis. Diçka për këtë persiatje, tani, ne rolin e studjuesit, që afishohet qysh në titull...?

Pergjigje: -Nuk pretendoj të sqaroj apo të analizoj në detaje veprën e Vangjel Zafiratis; atë të ta bëjnë persona me kompetente, por me dijet, aftësitë dhe devotshmerinë që pretendoj se kam; shpreh kënaqësinë time për veprën e tij. Tek ajo mendoj se kam gjetur të skalitur një nivel të lartë estetik, artistik, moralin e lartë dhe njeriun vizionar me plot frymëzim. Elemente këto, që kanë nxitur joshjen time në këtë botim. Nderkohe, qëllimi është evokimi i respektit, dashurisë dhe mbështetjes ndaj njeri - tjetrit, ndaj intelektualëve, në luftë me urrejtjen, ambicien, keqdashjen, ankthin dhe semundjen, të cilat shpesh herë i ndeshim në veprimtarinë tonë të përditshme.” Momenti i së vërtetës”, nuk është

gje tjetër veçse shprehja e respektit dhe dashurisë, të nxitura nga stimulimet frymëzuese të veprës së autorit. Ai, nëpërmjet mekanizmit të fshirjes dhe pastrimit të mykut dhe lërnishqëve, nxjerr në pah të vërtetën. Kjo është e gjitha. E vërteta. Ose, tentativa për të arritur tek ajo. Një përpjekje dhe mundim për arritje. Sepse, të vërteta absolute nuk ka. Përparimet e shkencës dhe teknikes, e vetë jetës, janë përpjekje për të arritur tek liria. “Armiku më i madh i së vërtetës është mungesa e respektit për vlerat dhe autoritetin”, thotë Albert Ajnshtajni. Kështu, është i vërtetë fakti se kur lexon veprën e Vangjel Zafiratis, përjeton momente meditimi. Meditimi është një përfitim madhor, një qetësi shpirtërore, është një moment lirie që stimulon shëndetin të mirë.

-Si një mjek me përvojë që mbani titullin “Mjeshtër i Madh”, çdo të adresoni sintetikisht për shëndetin dhe raportin me të vërtetën!

Pergjigje: -Ta nis me përshëndetja shqiptare “Tungjatjeta”. Kështu që populli ynë ka gjetur urimin më të mirë e më të shpeshtë që i ofron njeri-tjetrit.

Koha që jetojmë karakterizohet nga tendenca e rrafshimit dhe mohimit të vlerave intelektuale. Stimulimi shpirtëror dhe intelektual që unë tentoj të bëj për këtë liber Vangjelit, veç të tjerave, është një element për shëndetin të mirë. E kam mik Zafiratin dhe si mjek mendoj për shëndetin e tij. Shkencërisht pranohet lidhja mes unitetit shoqëror, të qenit miqësor, mbështetjes shoqërore dhe shëndetit të mirë. Marrëdhëniet

e mira familjare dhe shoqërore, prodhojnë shëndet të mirë.

- Si e interpretoni thenien e Senekës: “ Miqësia është një mjekim universal, kundër të gjitha fatkeqësive”? Madje, për kundër stigmave që hasim në realitetin e përditshëm ?

Pergjigje: -Kjo pranohet shkencërisht, sepse eliminohet një faktor madhor demprues - semundje shkaktues siç është “stresi”. Studimet kanë treguar se stresi, zemerimet, emocionet negative, njerezit e vetmuar, njerezit me rrethë familjare e shoqërore të dobëta, janë të rrezikuar për semundje e sidomos për semundje të sistemit kardiovaskular. Stresi shkakton çrregullime të ankthit. Prandaj Seneka arriti në këtë përfundim; “ Miqësia është një mjekim universal, kundër të gjitha fatkeqësive”. Mesazhi sot: ti japim njeri - tjetrit shëndet me qëndrimet tona altruiste. Kundër stigmave, mendoj se është koha që të stimulojmë konceptin “qytetar sarandit” kundër ndasive të njohura, kundër prapambetjes, injorancës dhe grindjeve. Në këtë mënyrë do të çlirojmë shoqërinë tonë nga emocionet negative drejt një uniteti vizionar. Në qytetaret e Sarandës nuk jemi të ndarë e të vecuar. Po kuptuam këtë unitet, nuk ka nevojë për superioritet racor.

- Lidhja juaj me letrësinë , duke u kthyer të Zafiratis. Cgjetet të poezitë e tij?

Pergjigje: -Njihën shumë mjekë të perkushtuar në letrësi. Do të mjaftonte vetëm Cehovi... Persa i perket vetes time, mund të them se lidhjet e mia me letrësinë dhe

vijon në fq 13

DHIMITËR XHAFERI

Momenti i së vërtetës

në krijimtarinë letrare të Vangjel Zafiratis



Keta ishin shkencetare dhe kirurge me duar te arta. Ata e kane kthyer shkencen kirurgjikale ne art.

Vangjel Zafirati eshte poet I thellesive shpirtore. Duke u zhytur ne keto thellesi, ai eshte ne gjendje qe te degjoj e te dallojë dhimbjen e shpirtit. Pikerisht, kete ndjenje te dhimbjes e konstatojme te skalitur midis rreshtave te vepres se tij autori. Per mua si kirug, eshte pikerisht ndjenja e dhimbjes qe me ka ndihmuar per te kuptuar e ndier me mire vepren e Vangjelit. Te qenit poet eshte privilegji I natyres dhe per ata qe besojne ne fe, eshte privilegji i Zotit. Eshte privilegji, sepse shkencat e tjera (inxhinieria, ekonomia, elektronika) ushtrohen brenda kuadrove ligjore dhe rregullave teknike, kurse poeti, kur krijon poezine, fantazon per te realizuar deshirat e paplotesuara te njeriut (sic thote Froidi), kerkon te korrigjoe realitetin (pra del jashte ligjeve kohore), keshtu ai nuk merr parasysh ligjin)

Edhe kirurgjia, ashtu si poezia, eshte e vecante, sepse ushtrimi I saj eshte privilegji. Perse eshte privilegji? Kirurgu, kur hyn ne zonat e veshtira te krijimtarise se tij dhe ndeshet ashper me vdekjen, pikerisht ne kete moment ai merr vendime pavaresisht dhe mbi cdo kuader ligjor. Eshte momenti qe vendoset "perpara" Iigjit dhe mbi te. Prandaj kirurgjia eshte si poezia, privilegji. Kirurgu germon indet dhe heq te keqen. Vangjel Zafirati ne studimet e tij folklorike nuk ben gje tjeter, vec germon. Vangjel Zafirati perpunon fushen e tradites kulturore dhe kalon nga legjenda tek realiteti dhe tek freskia. Bisturia e kirurgut duhet te jete precize, ne vijen e incizionit dhe ne prerjen e indeve, se bashku me ndjenjen e dhimbjes ndaj vuajtjes se te semurit.

Kendveshtrimi I V. Zafiratis mbi motivet e perjetshme njerezore, eshte jo vetem original, por edhe nje edukues I fuqishem I brezave. Te kujtojme thenien e Nices: " Mbi cdo popull qendron pezull nje table e gjerave te mira". Poeti I nje vargjet e tij, po ashtu edhe lexuesit, te cilet pasi lexojne

nje poet, thone: keto jane vargjet e filan poeti. Ashtu edhe kirurgu, ne vijat e incizioneve te shumta e te panumerta qe ka kryer, lexon vuajtjen e pacienteve dhe perpjekjet e tij per t'1 shpetuar te semuret. Pra, cikatricet (shenjat) qe ngelen pas operacioneve ngjajne me vargjet e poetit.


Kontributi I tij shume palesh, formulon konceptin e tij te sakte mbi jeten ne komunitetin ku jeton. Filozofi I shekullit te 17-te, Francis Bekon, udhetonte me zotnin e vet ne karroca te vecanta shte peridhe dimri dhe bente shume ftohte. Ndaluan ne nje fshat malor dhe blene secili nga dy pula per t'1 patur si ushqim gjate rruges. Francis Bekon zbriti nga karroca e tij, hoqi pelerinen, hodhi ne te, debore mbeshtolli pulat dhe I futi ne karroce.. Zotnia e tij predikonte se pulat nuk kane nevojte te futen ne debore, sepse nuk prishen. Kur mberriten ne destinacion, karroca e Zotnise mbante ere, kurse karroca e Francis Bekon ishte e fresket. Tani ne, nuk hame dot pulat e Francis Bekon, por konceptin e tij.

Le te respektojme pra konceptet e drejta te Vangjel Zafiratis per jeten dhe unitetin njerezor, per miqesine, e cila shkaterron hidhenimin dhe mban te fresket shoqerine dhe mjedisin ku jetojme.



Bisedoi: Panajot BOLI

“Sa tokë i nevojitet një njeriu?”



NGA LEON TOLSTOI

Nje nga historite e Leon Tolstoit eshte dhe kjo, histori e vogel. Ajo flet per nje bujk, Pahomin i cili me punen e tij fitoi shume pasuri dhe pasuria e tij e shumte, i ndezi lakmine per te fituar edhe me shume.

Fati e solli dhe Pahomi takon nje bujk tjetër i cili erdhi nga lartësitet e Vollges dhe nje tregtar endacak qe udhetonte nga nje vend ne tjetrin. Nga keta te dy, Pahomi meson per siperfaqe te medha toke qe mund t'i blike “per nje cope buke” nga disa nomade me kafshe te cilat transportoheshin nga nje vend ne tjetrin. Ata

i quanin “Baskirs”.

Nuk vonoi Pahomi dhe u nis. Udhetoi dhe arriti ne token e larget. Toka, ishte e virgjër dhe e bute si pellemba e njeriut dhe e zeze si fara e lulekuqes dhe bari ishte i larte deri tek gjoksi.

- Cili eshte cmimi? - pyeti Pahomi

- Cmimi tone eshte gjithmone i njejte, njemije rubla ditën. - ju pergjigjen.

Pahomi nuk po kuptonte.

- Diten? Cfare cmimi eshte ky? Per sa hektare eshte ky cmim?

- Nuk dime ta llogarisim- tha i madhi i tyre.

- E shesim me dite. Sa te mundesh te ecesh ne nje dite, deri aty, ku do te shpien kembet e tua brenda dites, aq toke do blesh me njemije rubla.

Pahomi nuk mund te fliste nga befasia.

- Me gjithë mend? - pyeti, - Por per nje dite, une mund te pershkoj nje siperfaqe te madhe...

I madhi i tyre, qeshi.

- Do jete e gjitha tendja, - i tha! - Por me nje kusht. Do duhet qe ne te njejten dite te kthehesh ne te njejtin vend, nga u nise. Nese, nuk do te kthehesh deri ne mbremje ne vendin nga u nise, leket e tua, jane te humbura.

Ate nate Pahom nuk mund te flinte. Para se te gdhihej e mori gjumi dhe filloi te enderronte. Enderronte sikur ishte ne cadren-tende te tij

dhe degjonte te qeshura nga jashte. Guxoi dhe doli jashte dhe pa te madhin e nomadeve te Baskireve te ulur afer cadres se tij duke mbajtur barkun me dore nga te qeshurat. Duke ju afruar me teper, ju be si ai endacaku qe kishte takuar ne token e tij, dhe, duke ju afruar me teper, e kuptoi qe ishte ai bujku qe kishte ardhur nga lartësitet e Vollges. Por me ne fund nuk ishte as ai. Ishte vete djalli me brire dhe me kembe kafshe, me patkonj qe i godiste ne toke. Perpara djallit ishte shtrire nje burre kembezbathur i veshur vetem me pantallona dhe kemishe. Dhe, duke enderruar akoma Pahomi, vajti afer njeriut te shtrire dhe njohu veten, veten e tij....te vdekur!

Pahomi i tmerruar u ngrit si vetetime nga krevati, - “C’ nuk enderrron njeriu!...-- tha me vete.

Pahomi vajti tek kodrina qe kishin lene takim kur qielli filloi pak nga pak te zbardhej. Vendosi njemije rublat ne brendesi te kapeles prej gune te lene pertoke, te te madhit te nomadeve dhe filloi... Hapi i tij, nuk ishte as i shpejte por as i ngadalte. Por duke vazhduar ecjen i bente hapat me te medha dhe ne cdo hap qe bente, i dukej toka me e bukur. Dhe para se te vinte nje shenje dhe te kthehej, pa nje lendine akoma me te bukur dhe vazhdoi te ecte... Keshtu rrodhi pothuajse gjithë dita

vijon në fq 15

dhe tani, duhej te nxitonte dhe ecte shume shpejt poshte diellit qe digjte tmerresisht akoma edhe pse ishte afer perendimit.

Tej mase i lodhur, pasi pershkoi gjithë siperfaqen qe eci, Pahomi filloi te eci drejt kodrines nga ku ishte nisur, duke i zvarritur kembet e tij. Gjoksi i ulej dhe ngrihej si forxha e kovaceve, zemra i rrihte si cekici, kembet filluan pak e nga pak ta braktisin. Pas pak.. Pahomi pa kodrinen nga ku ishte nisur si dhe Baskirset qe i flisnin.

Dhe Tolstoi e mbyll kete histori: "Pahomi pa diellin qe kishte prekur token. Nje pjese e tij pothuaj kishte perenduar. Me gjithë fuqine qe i kishte mbetur nxitoi aq shume, sa qe trupi i tij shkonte sa para-mprapa dhe kembet e tij capiteshin, aq sa mos te binte. Sapo preku kodrinen, befas u erresua. Pa lart, dielli tashme kishte perenduar! Briti me agoni:-"Gjithe mundi im

shkoi dem....," dhe duke menduar te ndalonte degjoi Baskirset t'i bertasin dhe u kujtua qe nese dielli aty kishte perenduar tek kodrina, ende akoma. Mori fryme thelle dhe hipi mbi kodrinen. Aty vertet kishte akoma drite. Kur arriti pa pertoke kapelen e gunte. Afer saj ishte ulur i madhi i tyre dhe duke mbajtur mesin qeshte me te madhe. Pahomit ju kujtua endrra e tij dhe i doli nje britme. Kembet e braktisen, u rrezua para dhe rrembeu kapelen me rublat ne duart e tij... Vdiq nga stermundimi i madh.

Sherbetori i tij mori nje lopate dhe germoi nje grope aq sa ta merrte Pahomin e gjore dhe e varrosi aty. Gjashte kembe, qe nga koka deri tek kembet, i duheshin per t'ia arritur qellimit, i gjori.


.....
"Sa toke i nevojitet nje njeriu?". Nje histori me fuqi te madhe dhe me rezonance globale, sepse lakmia, babezia dhe grykesia jane semundje dhe infektojne shpirtin

e gjithë njerezimit. Askush nuk pranon qe mund te jete lakmitar dhe i babezitur. Por realiteti eshte qe cdo dite, predikues dhe klerike, diku bejne nje varrim te dikujt qe e harxhoi jeten e tij, sakrifikoi gjithcka, akoma edhe familjen e tij qe te arrije ne maje te nje kodrine te Pahomit, per te fituar sa me shume...



Perktheu: Vasilika IFANDI

- AJMMI - PEJZAZH - AJMMI - PEJZAZH - AJMMI - PEJZAZH - AJMMI - PEJZAZH - AJMMI - PEJZAZH - AJMMI - PEJZAZH -



Pejzazh. Ku takohet lumi i Zagories me Vjosën
(FOTO_SH.H-AJMMI)



**DHIMITËR MIÇI, MJESHTRI I FIDANISHTES SE ÇERTIFIKUAR NE LIVADHJA.
ME E MADHJA DHE ME MODERNIA NE JUGUN SHQIPTAR**

(Foto: SH.H-AJMMI)

**ABONOHU TEK REVISTA" URAT E
MËJEDISIT"**

Stafi botues dhe redaksia e revistes: **URAT E MËJEDISIT** "vazhdon te pranoje kerkesat e reja per abonim vjetor ose 6 mujor per vitin 2016. Redaksia mer persiper ta dergoje revisten deri tek porositesi me shpenzimet e veta dhe brenda nje afti dy ditor nga botimi. Riperserisim se kuota per abonim vjetor eshte 2500 lek. Per tju ardhur

ne ndihme subjekteve te ndryshme, stafi botues pranon edhe abonime 6 mujore me vlere 1500 lek. Agjencia "AJMMI" si botuese e kesaj reviste, pranon materiale si: artikuj problemor, fotografi, krijime artistike e letrare me teme problemet qe trajtojnë mjedisin natyror, shoqëror dhe më gjerë.
**AGJENCIA JONIANE E MËJEDISIT,
MEDIAS DHE INFORMACIONIT**

Për kontakt: 069-303-1436